



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1 pika 1.3 paragrafi (ç) pika 1.7. paragrafi (d) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke pasur parasysh fushëveprimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përkitazi me politikat e veprimit për mbrojtjen e familjeve dhe të miturve.

Me qëllim të avancimit të pozitës së fëmijëve të braktisur dhe pa kujdes prindëror, **Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:**

P R O P O Z I M NR. 04/2005

**PËR NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV
NR. 16/2004 PËR RREGULLIMIN E STREHIMIT FAMILJAR NË KOSOVË**

Neni 1

1.1. Paragrafi 6.1 i nenit 6 ndryshohet dhe plotësohet në mënyrë që shuma prej 90€ të zëvendësohet me shumën prej 100€

1.2. Paragrafi 6.3 i nenit 6 bartet në paragrafin 6.5 të po këtij neni dhe ndryshohet në pasuesin e

fundit, dhe do të ketë këtë përmbajtje: Varësisht nga mundësitë buxhetore dhe rrethanat e tjera shuma e pagesave mujore për strehim familjar mund të ndryshojë me vendimin e MPMS-së.

- 1.3.** Nenit 6 i shtohet paragrafi i ri 6.3 me këtë përmbajtje: Të drejtë përfitimi sipas këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve të këtij Udhëzimi Administrativ do të kenë ata fëmijë të cilët nuk përfitojnë nga skemat e tjera të rregullta mujore të mirëqenies sociale të menaxhuara nga MPMS-ja.
- 1.4.** Paragrafi 6.4 i nenit 6 ndryshohet dhe plotësohet në tërësi. Paragrafi i ri 6.4 do të ketë këtë përmbajtje: Për fëmijët të cilët janë gjithashtu pa kujdes prindëror dhe pa mjete për ekzistencë, nën kujdestari dhe të strehuar tek të afërmit e tyre do t'iu bëhet pagesa në shumën mujore prej 50 € për një fëmijë.

Neni 2

- 2.1.** Nenit 7 të Udhëzimit Administrativ i shtohet paragrafi i ri 7.3 me këtë përmbajtje: Për shkak të sigurisë më të lartë juridike dhe për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisve kontraktuese, Qendrat për Punë Sociale duhet të lidhin kontratë me shkrim me familjet strehuese.

Neni 3

- 3.1.** Propozimi nr. 04/2005 për ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzimit Administrativ nr. 16/2004 për rregullimin e Strehimit Familjar në Kosovë, hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të aplikohet nga 01.01.2005.

Prishtinë, prill 2005

Ministri i MPMS-së
Ibrahim Selmanaj
